

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN XHAFZOTAJ

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Xhafzotaj, njësi administrative e Bashkisë Shijak**, me objekt: “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 1.01.2013 deri më datë 31.05.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 102, datë 31.07.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 565/5, datë 31.07.2015, i ka rekomanduar z.Ardian Kokomani, Kryetar i Bashkisë Shijak, ku përfshihet si njësi administrative ish komuna Xhafzotaj, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në kundërshtim me ligjin 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, neni 16 dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 07.07. 2000 “Për sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore, individuale të nëpunësve civilë”, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr.109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, si dhe VKM nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”, nuk është kryer procesi i vlerësimit të arritjeve individuale të punonjësve, si pjesë e politikës nxitëse dhe motivuese.

1.1 Rekomandim: Bashkia Shijak (në të cilën përfshihet komuna Xhafzotaj), të kryejë në vazhdimësi procesin e vlerësimit të arritjeve individuale të punonjësve, si pjesë e politikës nxitëse dhe motivuese, duke zbatuar kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr.109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, si dhe VKM nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”. Në vlerësimin e performancës së punonjësve, të realizohet monitorimi i vazhdueshëm, nëpërmjet takimeve periodike me çdo nëpunës, duke pasqyruar performancën, problematikat e zgjidhjet e mundshme, deri në finalizimin e tij, vlerësimin përfundimtar objektiv nga ana e eprorëve, sipas shkallëve hierarkike, në nivel funksioni apo aktiviteti.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumenteve dhe të dhënave të paraqitura, nga Zyra e Tatim Taksave, rezulton se, nuk janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), 4 subjekte, që kryejnë aktivitete të ndryshme biznesi, të cilët ushtrojnë aktivitetin, pa u licencuar dhe nuk paguajnë taksë biznesi të vogël dhe tarifat vendore. Bazuar në nenet 11, 22 dhe 32 të ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, është bërë vlerësimi, dhe kanë llogaritur në planifikim të ardhura për buxhetet e viteve 2013 dhe 2014 për këto biznese të pa licencuar, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhet **për vlerën 109,230 lekë**.

2.1 Rekomandim: Bazuar në nenin 70, pika 3, “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, për 4 subjektet (sipas pasqyrës) të evidentuara si të pa licencuara, të kryhen llogaritjet, për detyrimet e gjobat dhe të nxirren njoftimet e vlerësimit për detyrimet që kanë ndaj Komunës, për vlerën gjithsej **109,230 lekë**, dhe të kërkohet arkëtimi i kësaj vlere.

Brenda muajit Tetor 2015

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013, taksa e tokës bujqësore ishte parashikuar të realizohej në vlerën 7,000 mijë lekë është realizuar vlere 2,783 mijë lekë ose 40%, nga ku rezultojnë debitorë **1050** familje për vlerën **4,217 mijë lekë**.

Për taksën e ndërtesës janë debitorë **1851** familje në vlerën **168 mijë lekë**. Taksa e pastrimit është realizuar 76.6% ose me diferencë në 841 mijë lekë për të cilën janë debitorë **498** familje, për vlerën **249 mijë lekë** dhe 592 mijë lekë i përket biznesit.

Për vitin 2014, taksa e tokës bujqësore ishte parashikuar të realizohej në shumën 7,000 mijë lekë është realizuar 5,112 mijë lekë ose 73%, nga ku rezultojnë debitorë **1050** familje, për vlerën **1,880 mijë lekë**.

Gjithsej, vlera debitorë e subjekteve familjare arrin në shumën totale **7,106 mijë lekë**, nga e cila **6097 mijë lekë** për taksën e tokës, **841 mijë lekë** për taksën e ndërtesës, **168 mijë lekë** për taksën e pastrimit .

3.1 Rekomandim: Bashkia Shijak (në të cilën përfshihet komuna Xhafzotaj nga shkrirja e NJQV), të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë të pa likuiduara deri më datën 31.12.2014, për tre llojet e taksave të popullatës në vlerën totale **7,106 mijë lekë**, përkatësisht: për taksën e tokës, në vlerën **6,097 mijë lekë**, taksa e banesave në vlerën **841 mijë lekë** dhe taksa e pastrimit në vlerën, **168 mijë lekë**.

Brenda datës 31.03.2016

4. Gjetje nga auditimi: Komuna Xhafzotaj ka bërë në 1 rast, shkëmbim të një prone, pasuri të paluajtshme të komunës, me një pronë pasuri private e një personi fizikë dhe konkretisht: Në zonën kadastrale nr. 3255, volumi 7, faqe 101, pasuria me nr. 152/12, adresa Sallmone-Xhafzotaj-Durrës, me lloj pasurie Tokë Arë, me sipërfaqe 310 m2 me indeks të hartës K34-88 (226-D), Truall+Ndërtesë, zona kadastrale nr. 3255, volumi 8, faqe 65, pasuria me nr. 173/24, adresa Sallmone-Xhafzotaj-Durrës, me sipërfaqe totale 250 m2 , nga të cilat 250 m2 janë truall në të cilin ndodhet një ndërtesë me sipërfaqe 147 m2, me indeks të hartës K34-88 (226-D).

Për shkëmbimin e kësaj prone dosjen e hartuar, mungojnë këto dokumente:

- akt vlerësimi të pasurisë nr. 173/24, në zonën kadastrale nr. 3255, si dhe pasurisë nr. 152/12 të ndodhur në zonën kadastrale nr. 3255;
- Relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës në Këshillin e Komunës;
- Miratimi nga Institucioni i Prefektit të veprimit të kryer, dokumentacion i cili pretendohet se ka qënë, pjesë e praktikës së ndjekur

4.1. Rekomandim: Bashkia Shijak (në të cilën përfshihet komuna Xhafzotaj nga shkrirja e NJQV), të marrë masa për pajisjen e dosjes së shkëmbimit të pasurisë nr. 152/12, adresa Sallmone-Xhafzotaj-Durrës, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Brenda muajit Shtator 2015

5. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2013, 2014 dhe 5 mujori i vitit 2015, nuk është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësimin e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, të përcaktuara në Kapitulli III, “Regjistri i Aktiveve dhe dokumentimi i Lëvizjes së Tyre”, Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara pika 42, 43 dhe 44 të UMF nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenin 4/26 të ligjit 10296, date 0.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” .

5.1. Rekomandim: Bashkia Shijak (në të cilën përfshihet komuna Xhafzotaj nga shkrirja e NJQV) të marrë masa për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin si dhe plotësimin e tyre me dokumentacionit shoqërues

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në përgjithësi në të gjitha Urdhër-shpenzimet e plotësuar për të kryer likuidimet e punëve, shërbimeve e mallrave të blera nuk janë shoqëruar me dokumente autorizues dhe vërtetues sipas përcaktimit në Kapitullin III, “Regjistri i Aktiveve dhe Dokumentimi i Lëvizjes së Tyre” Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve pika 35, gërma a, b dhe c të UMF nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenin 4/9 të ligjit 10296, date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” .

6.1. Rekomandim: Bashkia Shijak (në të cilën përfshihet komuna Xhafzotaj nga shkrirja e NJQV), të merren masa të menjëhershme nga sektori i financës, për mos likuidim të asnjë fature për mallrat e blera, apo shërbimet e kryera në qoftë se ato, nuk shoqërohen me dokumente autorizues dhe vërtetues, sipas përcaktimit në UMF nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi: Në Urdhër-shpenzimet për pagesat e kryera në paga, nuk kanë bashkëngjitur listë- prezencat e firmosura sipas përcaktimeve në pikën 69, Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlere Kapitulli III, “Regjistri i Aktiveve dhe Dokumentimi i Lëvizjes së Tyre” të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe nenin 4/9 të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” .

7.1. Rekomandim: Bashkia Shijak (në të cilën përfshihet komuna Xhafzotaj nga shkrirja e NJQV) të marrë masa, që të bashkëngjiten listë- prezencat e firmosura në urdhër-shpenzime për pagesat e kryera në paga, për vitin 2013- 2014 dhe në vazhdim.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Janë kryer shpenzime pa pasur Urdhër prokurimi me vlerë mbi 10.000 lekë, duke mos zbatuar prokurimi me vlera të vogla, këto blerje kryhen në vend pa u respektuar procedurat normale elektronike, por në prani të personave, përfaqësues për ngjarjen e ndodhur. Nuk është hartuar procesverbal midis personave të pranishëm dhe nuk i janë dorëzuar këto dokumente komisionit të prokurimit me vlera të vogla, nuk kanë nënshkruar faturë dhe të gjithë këto dokumente nuk i kanë dorëzuar në zyrën e financës në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimeve me vlera të vogla” i ndryshuar të APP .

8.1. Rekomandim: Bashkia Shijak (në të cilën përfshihet komuna Xhafzotaj nga shkrirja e NJQV) të marrë masa, që për rastet e blerjeve dhe kryerjen e shpenzime me vlerë mbi 10,000 lekë, të zbatohen procedurat e përcaktuara në Udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimeve me vlera të vogla” i ndryshuar.

Vazhdimisht

9. Gjetje nga auditimi: Dosjet e prokurimit për vitet 2013 dhe 2014 nuk janë inventarizuar si dhe nuk janë arkivuar në kundërshtim me Ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Rregulloren “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”, pika 1 e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit Publik.

9.1. Rekomandim: Bashkia Shijak (në të cilën përfshihet komuna Xhafzotaj nga shkrirja e NJQV) nëpërmjet njësisë së prokurimit, të kryej inventarizimin e brendshëm të dokumentacionit të tenderëve, në përputhje me ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, si dhe nenin 30, Modeli nr. 8 të Miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Vazhdimisht

10. Gjetje nga auditimi: Sipas arkivës elektronike të APP, konstatohet se në sistem nuk janë përmbyllur procedura e njoftimit të lidhjes së kontratës si dhe arkivimi i saj në zbatim të Udhëzimit Nr. 4, datë 04.07.2013 të APP në të cilin citohet “Autoriteti Kontraktor duhet të bëjë arkivimin e procedurës së prokurimit brenda 1 dite pune nga mbyllja e fazës së njoftimit fituesit” .

10.1 Rekomandim: Bashkia Shijak (në të cilën përfshihet komuna Xhafzotaj nga shkrirja e NJQV) të bëjë arkivimin e procedurave të prokurimit sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 4, datë 04.07.2013 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

Vlera limit e kontratës e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit prokurimit të hartohet nga specialistë të fushës, ta dokumentojnë këtë llogaritje mbështetur në tarifa, çmime të miratuara në manualët në fuqi dhe të bashkëngjite dosjes së prokurimit si baze e nxjerrjes së dhënave ashtu dhe llogaritja e saktë.

Vazhdimisht

11. Gjetje nga auditimi: Mallrat e blera në vitet 2013, 2014, janë bërë hyrje në magazinë me fatura të pa firmosura dhe pa mbajtur proces-verbal nga komisioni i marrjes në dorëzim, në kundërshtim përcaktimin në kapitullin “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” Kapitulli III, “Regjistri i Aktiveve dhe Dokumentimi i Lëvizjes së Tyre” Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve pika 42, 43, 44, 47, 54) të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenin 4/26 të ligjit 10296, datë 0.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” .

11.1 Rekomandim: Bashkia Shijak (në të cilën përfshihet komuna Xhafzotaj nga shkrirja e NJQV) të merren masa, të menjëhershme që Nëpunësi Zbatues, para marrjes në dorëzim të dokumenteve, nga personat me përgjegjësi materiale, të kryejnë kontrollin paraprak të tyre, si nga pikëpamja rregullshmërisë dhe saktësisë.

Vazhdimisht

17. Gjetje nga auditimi

Veprimtaria e INUV, është tepër e kufizuar, me përmbushjen e detyrave të përcaktuara në nenin 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar.

Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Vendor, nuk ka marrë masat për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, prishjen e ndërtimeve pa leje pezullimin e punimeve në ndërtim deri në një afat kohor paraprak të nevojshëm për marrjen e vendimit për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm, vendosjen e gjobës sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në këtë fushë, për kallëzim penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe ta paraqesë atë pranë organeve përgjegjëse .

17.1 Rekomandim:

Të merren masa, nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor, që në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, të evidentojë ndërtimet pa leje, duke aplikuar gjoba ndaj subjektet ndërtuese të kundra ligjshme, me qëllim mbajtjen nën kontroll, administrimin dhe zhvillimin e territorit.

Menjëherë

B. MASA DISIPLINORE

B.1 Mbështetur në nenin 58, germa a, b, c, ç “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenin 8, të kontratave individuale të punës, neni 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i kemi kërkuar Kryetarit të Bashkisë Shijak (në të cilën përfshihet Komuna Xhafzotaj), vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**” dhe për ata me kontratë nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënie të punës**”, për këta punonjës:

1. Znj. B.T, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës;
2. Z. M.D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO;
3. Z. M.T, me detyrë mbikëqyrse e punimeve;
4. Znj. S.Gj, në cilësinë e anëtarit të KVO;
5. Z. S. M, në cilësinë e anëtarit të KVO

B.2 Mbështetur në nenin 58, germa a, b, c, ç “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenin 8, të kontratave individuale të punës, neni 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i kemi kërkuar kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Shijak (në të cilën përfshihet Komuna Xhafzotaj), vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masës disiplinore “**Vërejtje**” për këta punonjës:

1. z.R.Sh, me detyrë specialist i Kadastrës;
- 2.z. F.Sh, me detyrë Agronom;
- 3.z. F. H, me detyrë Arkitekt;
4. z. A.D, me detyrë Përgjegjës i INUV;
5. z. L.B, me detyrë specialist i INUV
6. znj. L.I, me detyrë Inxhinjere Ndërtimi.

Nga Bashkia Shijak, ku përfshihet njësia administrative Xhafzotaj, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Mimoza Lloji, Vasil vane, Mirosh Bogdo dhe Taulant Dervishaj, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram

Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHITIT